



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:280841
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06163145

C.nr.4866/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestuese të paditësit S.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti padi për kompensimin e pagës jubilarë, vlera e kontestit 266.70 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Pa shqyrtim kryesor)

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadija e paditësit **S.M.** nga Prizreni, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të shpërblimit të një page jubilarë për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të 50% të një page bazë t'ia kompensoj shumën prej **247.55 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 14.12.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave jubilarë në shumën prej **19.15 euro**, përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin nën I, **si e pa bazuar**.

III. DETYROHET e paditura që paditësit S.M. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi S.M. nga Prizreni përmes të autorizuarës së tij av. S.M.N. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 14.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës jubilarë (neni 35 par.8 të Kontratës Kolektive), vlera e kontestit 266.70 euro.

Në referatin e padisë, e autorizuarja e paditësit ka theksuar se paditësi është në

marrëdhënie të punës si mësimdhënës pranë SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, i njëjti në bazë të kontratës së punës dhe listës së pagave ka gjithsej 17 vite përvojë pune pranë SH.F.M.U. “Shjefën Gjeçovi” që nga data 01.09.2012. Më tej ka theksuar se bazuar në Ligjin e Punës nr.03-L/212 neni 90 par.5 dhe në bazë të nenit 35 par.8 pika 8.1 të Kontratës Kolektive të datës 22.01.2021, është paraparë shpërblimi jubilar në vlerë prej 50 % të një page bazë për 10 vite përvoj pune, respektivisht shumë prej 266.7 euro të një page bazë 533.40 euro. Meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e pagës jubilarë, i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe 20.00 euro për taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit.

Gjykata përmes kontratës së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 33/01/2000, të datës 20.10.2015, ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit në vendin e punës mësimdhënës, nga vërtetimi me numër të referencës 205/23, të datës 06.12.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Sabit Muqaj është në marrëdhënie

punë në SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” nga data 01.09.2012 dhe ka 17 vite përvojë pune. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se paditësi e ka koeficientin e pagës 7.8, e shikuar në përgjigjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit LAGJ.nr.1/23-74 të datës 29.11.2023, është përcaktuar se paga bazë për drejtor të shkollës fillore është 495.30 euro.

Kontratën e punës për mësimdhënës dhe vërtetimin e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”* Andaj meqë këto janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që, vërtetimin e lëshuar nga ana e SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, si provë me të cilat vërtetohen faktet lidhur me përvojën në punë, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, më saktësisht duke marrë për bazë periudhën se kur pala paditëse ka arritur vitin jubilar prej 10 vitesh, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.8, nën par.8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: “për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t’ia paguaj kompensimin e pagës jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shumën e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesën e paditësit në shumën prej 19.15 euro, pasi që erdhi në përfundim duke i njohur vetëm përqindjen në pagën mujore bazë (pa shtesa).

Gjykata vlerëson se paga mujore me shtesat tjera të paraqitura në listën e pagave dhe atë pagesa e pagave jubilarë, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësi, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës dhe shtesave tjera në punë. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, andaj vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë 14.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilim e padsisë dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro, pasi që kontesti është i vlerës së vogël.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4866/23, dt.16.09.2024

B.profesional.
Ali Kosova

Gjyqtari
Shaban Shala

Numri i lëndës: 2023:280841
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06163145

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.